



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 26-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 20. 12. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Egzona Fazliu, anëtare
29. Arben Salihu, anëtar
30. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës
4. Avni Olluri, drejtor i DA

5. Shkelzen, Hajdini, drejtor i DEZH
6. Rasim Hasani, drejtor i DKA
7. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
8. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
9. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
10. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
11. Bekim Shabani, drejtor i DRKS
12. Vlorë Limani-Hajnuni DSHMS
13. Islam Kaleshi, zyra ligjore
14. Gafur Hetemi, zyra pronosore juridike
15. Besart Troshupa, zyra e informimit
16. Kimete Jashanica, OSBE
17. Bestar Ibrahim, zyrtar i teknologjisë
18. Haki Avdiu, zyrtar i teknologjisë
19. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 25-të Kuvendit.
2. Propozim Rregullore për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunën e Lipjanit.
3. Propozim vendim për hartimin e projektit të programit komunal tre vjeçar për banim 2020-2023.
4. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarëve të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Gadime e Ulët dhe Babush i M.
5. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarëve të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Gadime e Ulët.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Avni Olluri, në emër të Kryetarit të Komunës propozoi që të shtohen edhe 2 pika.

- Rregullore për Taksat Komunale
- Rregullore mbi transparencën në Komunën e Lipjanit

Lulzim Rrustemi, së pari ju uroj festat e fundvitit të gjithëve pastaj kam një propozim që Ramiz Qeriqi të zëvendësohet në komision.

Daut Azemi, sa i përket çështjes së Ramizit kur të hyjmë te pika e anëtarëve të komisionit e propozoni.

Meqë vërejtje tjera nuk pati rreth rendit të ditës Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se me të gjitha votat prezente, kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Shkelzen Bislimi, vendimi për ndalimin e mjeteve piroteknike është një vendim i mirë që e ka marrë Kryetari por është mirë që me u bërë edhe një autorizim se kush ka të drejtë me i shitë këto mjete.

Çështja tjetër ka të bëjë me shkollën fillore të vjetër “Emin Duraku” në Banullë e cila është bërë vatër e narkotikëve.

Ramiz Qeriqi, së pari më vjen mirë që janë vetëdijësu Vetvendosja në marrje të pushtetit. Kam një shqetësim dhe një kërkesë te rruga dy korsi te restaurant “Pishat” te vendkalimi i udhëtarëve janë mbetë tri vija dhe është mirë të mbetet vetëm një. Disa punë që po bëhen rreth hekurudhes nuk po bëhen mirë dhe nuk e dijë a ka ndonjë mbikëqyrës që e përcjellë punën e asaj kompanie pasi që ajo kompani është e pa përgjegjësme dhe unë i kam bërë disa foto se si është qitë betoni e të cilat po ju sjelli tani. Çështja tjetër ka të bëjë me banesat sociale të cilat kur ju kemi dhënë unë kam kërkuar që mos të jetë qiraja e banesës më shumë se 20€ pasi që nuk munden ta përballojnë. Pasi që ka nga ata që ju ka shku një shkresë nga komuna që nëse brenda 15 dite nuk e bëjnë pagesën do të largohen nga ato banesa. Është mirë që me u nxjerrë një Rregullore tjetër dhe me ju lehtësu atyre pagesa.

Lumturije Bytyq-Hasani, kërkoj një sqarim nga drejtoresha e shëndetësisë pasi që në QKMF është blerë një aparat i hemogramit por i cili nuk është në funksion. Çështja tjetër ka të bëjë me festat zyrtare është mirë që inspektoriat me inspektu marketet dhe me i pa se si punëtorët nuk pushojnë asnjë ditë.

Shkelzen Bislimi, është mirë me u vetëdisu njerëzit që e marrin pushtetin por më vjen keq për njerëzit që kanë nejtë gjatë në pushtet e nuk janë vetëdijësu deri tani.

Lulzim Rustemi, kam një kërkesë për ekzekutivin nga banorët e fshatit Lluga për rrugën veteranët e UÇK-së të paktën nëse ka mundësi bile të zhavorohet në kohën e dimrit.

Nazmi Krasniqi, kam një kërkesë të tragëtarëve një lloj peticioni të cilët kundërshtojnë të shkojnë te tregu i ri për shkak të tensionit të lartë dhe largësisë që ka ky treg, besoj që edhe juve ju ka ardh një shkresë e tillë.

Argjend Tasholli, do t'i ngris disa çështje së pari po filloj me problemin e disa rrugëve në fshatin Gadime siq janë rruga “6 Maji”, “Ilirida”, “Ibush Tasholli”, Lumi, etj, kur do të përfundoj problemi ma këto rrugë. Çështja tjetër sa po i përkrah komuna fëmijët me nevoja të veqanta. Pse nuk po hapet konkursi për asistent për nevojat e veqanta kur dihet që kemi kuadra të mirë.

Albulena Kelmendi, së pari ju uroj festat e fundvitit të gjithëve. Kam disa çështje për t'i ngritur e para, para disa seancave një kuvendar nga pozita ka diskutuar për ditën e diel të jetë ditë pushimi për sektorin privat për supermarketet dhe lokale tjera pasi që ka kërkesa nga qytetarët që një gjë e tillë të vjen prap dhe të diskutohet në Kuvend. Çështje tjetër që dua ta ngris e që e kam ngritur qe disa herë është çështja e ujit të pijshëm që po ballafaqohemi, jo vetëm banorët e Lipjanit por edhe të fshatrave dhe shpresojmë që vitin e ardhshëm do të bëhet një zgjidhje.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, së pari falenderoj skulptorin nga Shqipëria për bustin e Skënderbeut që e ka bërë gratis. Po ashtu ju uroj festat e fundvitit të gjithëve. Sa i përket mjeteve piroteknike është një problem që përballen të gjitha komunat dhe ne ju kemi përgjigj shkresës së ministrisë dhe kemi marrë këtë vendim. Në vazhdim tha se çështja e shkollës së vjetër në Banullë me të drejtë u ngrit dhe do të shohim se si ta zgjidhim këtë çështje. Çështja e vijave të bardha kemi provuar t'i hiqim por do të shohim si ta bëjmë një zgjidhje ndoshta edhe duhet të mbyllet ajo pjesë. Kush do që gjenë të meta në projekte unë jam shumë mirënjohës dhe falenderues. Banesat sociale do të diskutohet sot dhe ju sot do ta merrni vendimin për banimin social 3 vjeçar. Asnjëri nga përfituesit e banesave sociale nuk do të largohet nga ato banesa. Për çështjen e shëndetësisë nuk jam në dijeni. Rruga në Lluga është në buxhet në vitin e ardhshëm. Tregu i gjelbërt do të dislokohet për të gjitha prodhimet jo ushqimore në tregun e ri, ndërsa produktet ushqimore do të jesin në vendin e njëjtë. Ne e kemi pranuar një shkresë nga këta tregëtar por nuk i kemi kth përgjigje pasi që nuk ka adresë se kujna me ju kth në përgjigje. Bizneset mund të punojnë 24 orë, ndërsa punëtorët vetëm 8 orë, ndërsa çështja e orarit të punës gjatë të dieleve ende nuk kemi fillu. Uji i pijshëm një ndër telashet më të mëdha me të cilën po përballen komuna e jonë por do të shohim vitin e ardhshëm dhe ta bëjmë një zgjidhje.

Ramiz Qeriqi, është një shkresë e cila i është dërguar këtyre personave nga zyra e Kryetarit në të cilën thuhet nëse nuk kryhen obligimet brenda 15 dite banesat do të kthehen në pronësi të komunës.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se shkresa ju ka shku por nuk ju ka thenë askush që do të detyrohen t'i lëshojnë banesat.

Argjend Tasholli, unë po flas për rrugë e jo për rrugica e të cilat ju janë premtuar këtyre banorëve e do të ishte mirë të paktën të zhavorohen nëse ka mundësi.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, Lipjani i ka 63 fshatra dhe ato rrugica për të cilat po flisni ju do të kryhen vitin e ardhshëm.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 25-të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes 25-të dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 25-të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Rregullore për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Ollurit, drejtor i DA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin.

Lumturije Bytyqi-Hasani, unë në KPF i kam dhënë dy vërejtje e jo vetëm një, vërejtja e dytë ka qenë përdorimi i automjeteve zyrtare gjatë inspektimit është mirë me pas një mbishkrim që do ta identifikonin inspektionin.

Shkelzen Bislimi, është mirë që është bërë kjo Rregullore dhe ne si të tillë e përkrahim.

Afrim Miftari, është mirë që komuna tani ka një Rregullore të shkruar dhe ne si të tillë e përkrahim por kam një vërejtje te neni 8 pika 4 në vend të GPRS duhet të jetë GPS.

Imri Ahmeti, qëllimi është që me pas një Rregullore të shkruar, do t'i pajisim veturat me GPS dhe do të ketë një kontrollë më të mirë pasi që do të ketë edhe shpenzime më të vogla. Unë e kam përdor veturën 24 orë dhe do të vazhdoj ta përdori pasi që ma lejon Ligji.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 30 votat për, aprovoi këtë:

III

Propozim vendim për hartimin e projektit të programit komunal tre vjeçar për banim 2020-2023.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Ilir Tashollit, drejtor i DSHP-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nehat Tërpeza, ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim dhe si të tillë e përkrahim.

Lulzim Rrustemi, edhe ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim por kemi edhe një propozim që të ketë edhe një raport për banimin 3 vjeçarë.

Meqë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Vendim dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM
PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË PROGRAMIT KOMUNAL TRE VJEQARË PËR BANIM
2020-2023

Neni 1

TË HARTOHET, Programi Komunal tre-vjeçarë për banim 2020-2023.

Neni 2

1.Qëllimi i hartimit të Programit për banim në Komunën e Lipjanit rezulton në:

- Krijimin e kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit,
- Zhvillimin e politikave adekuate dhe zbatimin e tyre me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike që këtë problem ta zgjidhin sipas parimeve të tregut.

Neni 3

Programi Komunal i banimit do të hartohet për periodë tre vjeqare 2020-2023, duke u mbështetur në analizën e nevojave për banim, konform dispozitave të Ligjit për financimin e Programeve të veçanta të banimit Nr.03/L-164 dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

Neni 4

1.Bartës i procesit të hartimit të dokumentit të Programit Komunal tre-vjeqar për banim deri në finalizim do të jetë Komisioni Komunal i cili do të formohet me Vendim të Kryetarit të Komunës menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi. Në përbërje të Komisionit kryesisht duhet të përfshihen zyrtarë nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale si dhe zyrtarë tjerë nga administrata komunale.

2.Punët administrative teknike për punën e Komisionit do t'i kryej Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarëve të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Gadime e Ulët dhe Babush i M.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Olluri, drejtor i DA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Daut Azemi, tha se komisioni do të ketë këtë përbërje nga ekzekutivi do të jenë: Bekim Shabani, dhe Nazim Gashi, nga subjektet politike Majlinda Sylejmani dhe Nazmi Krasniqi dhe nga sektori jo qeveritar Denis Gashi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK GADIME E ULËT DHE BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim, zëvendësohen dy anëtarët e Komisionit vlerësues të caktuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.463-48449 të datës 19.07.2019 për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr 463-14811 i datës 04.03.2019, ashtu që Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim me numër rendor 1, kryesues i komisionit nga ekzekutivi i Komunës zëvendësohet nga Bekim Shabani, Drejtor, nga ekzekutivi i Komunës ndërsa anëtari në numrin rendor 2 Ilir Tasholli, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime publike zëvendësohet nga , Nazim Gashi, Drejtor nga ekzekutivi i komunës,

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Anëtarët e sapozgjedhur kanë detyrë dhe përgjegjësi të vazhdojnë zhvillimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr 463-48449 të datës 19.07.2019 konform dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarëve të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Gadime e Ulët

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Ollurit, drejtor i DA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, kam një propozim që në vend të Ramiz Qeriqit, të jetë Argjend Tasholli.

Daut Azemi, tha se nga ekzekutivi do të jenë: Bekim Shabani dhe Nazim Gashi, ndërsa nga subjektet politike Majlinda Sylejmani po ashtu me propozim të grupit parlamentar të PDK-së në vend të Ramiz Qeriqit do të jetë Argjend Tasholli, ndërsa nga sektori jo qeveritar do të jetë Denis Gashi.

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 25 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK GADIME E ULËT

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim, zëvendësohen dy anëtarët e Komisionit vlerësues të caktuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.463-48439 të datës 19.07.2019 për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr 463-48346 i datës 19.07.2019, ashtu që Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim me numër rendor 1, kryesues i komisionit nga ekzekutivi i Komunës zëvendësohet nga Bekim Shabani Drejtor, nga ekzekutivi i Komunës ndërsa anëtari në numrin rendor 2 Ilir Tasholli, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime publike zëvendësohet nga, Nazim Gashi, Drejtor, nga ekzekutivi i komunës, ndërsa me kërkesë të anëtarit me numër rendor 4 ,Ramiz Qeriqi, dhe me kërkesë të subjektit politik ky anëtar ,zëvendësohet nga Argjend Tasholli

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Anëtarët e sapozgjedhur kanë detyrë dhe përgjegjësi të vazhdojnë zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr 463-48346 të datës 19.07.2019 konform dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI Rregullore për Taksat Komunale

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Ollurit, drejtor i DA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 27 votat për, aprovoi këtë:

VII Rregullore mbi transparencën në Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi i dha fjalën, Avni Ollurit, drejtor i DA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Rregullorja dhe tha se janë disa ndryshime te neni 11 te diskrimimet publike që ishte më herët 15 ditë, ndërsa te neni 12 paragrafi 7 nëse pala refuzohet ka të drejtë ankese brenda 15 dite.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 27 votat për, aprovoi këtë:

Pasi çështje të tjera nuk pati mblledhja përfundoi në ora 11,⁴⁰

**Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu**

**Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi**